



Tirana, 15.08.2007

LETET MBESHTETJEJE

AIPR është një organizatë e veçantë në sferën e organizatave joqeveritare në Shqipëri. Ajo ka qenë e pranishme në tregun e ideve me qasje, strategji, koncepte, mbështetje direkte për zgjerimin e rrugëve të komunikimit publik dhe përfshirjen e publikut në çështjet e qeverisjes.

Në mënyrë të vazhdueshme, CAO dhe drejtuesit e saj janë konsultuar me AIPR në lidhje me aktivitetet, mesazhet dhe artikullimin sa më të mirë e profesional të qasjeve me interes publik.

Përmes një produkti të përjavshëm informativ online, AIPR ka mbështetur po ashtu të gjithë operatorët në treg- duke përfshirë OJQ-te – për të rritur profilin e tyre publik dhe impaktin në mjedisin kombëtar.

Po ashtu AIPR ka qenë aktive në publikimin e vazhdueshëm të ideve të saj në fuqizimin e rolit të pushtetit vendor dhe të çdo instrumenti civil, që lehtëson përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje. Në kemi gjetur dhe gjejme tek AIPR një partner të besueshëm në punën tonë të përditshme, përmes një praktike bashkëpunimi dinamike dhe efektive, ku pasurohen idetë dhe fuqizohet efekti i çdo veprimtarie me theks publik.

Ju falenderoj paraprakisht për marrjen në konsideratë të kësaj Letre Mbështetjeje.

Me respekt

Kreshnik Spahiu
CAO
Drejtor